

VENDIM
Nr. 827, datë 24.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 171, DATË
27.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES ‘PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “d”, të nenit 2, emërtimi “Qendra e Formimit Profesional” zëvendësohet me fjalët “... qendrat e formimit profesional ...”.

2. Në pikën 7, të nenit 5, fjalët “... nuk mund të jenë më të vogla se 200 (dyqind) m² dhe më të mëdha se 5 000 (pesë mijë) m².” zëvendësohen me “... nuk mund të jenë më të vogla se 50 (pesëdhjetë) m² dhe më të mëdha se 6 000 (gjashtë mijë) m².”.

3. Në shkronjën “dh”, të nenit 8, fjalët “... qendra e formimit profesional përkatës.” zëvendësohen me “... qendrat e formimit profesional përkatëse.”.

4. Në nenin 14 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “... për vitin 2021 ...” zëvendësohen me “... për vitin 2022 ...”.

b) Në shkronjën “c”, të pikës 10, bëhen këto shtesa:

i. Në fund të nënndarjes “ii” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përrjashtëmish, subjektet, që paraqesin kërkesën për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 7, të këtij neni, paraqesin gjenerimin e mandatpagesës të përcaktuar më lart, nëpërmjet portalit *e-Albania*, para nënshkrimit të kontratës.”.

ii. Pas nënndarjes “ii” shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;”.

iii. Në fund të nënndarjes “iii” shtohen fjalët “... si dhe vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e stacioneve të plazhit, vetëm për subjektet që kanë kërkuar lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 7, të këtij neni.”.

5. Kudo në përmbajtje të tekstit të rregullores, fjala “aplikim” zëvendësohet me “kërkesë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama